**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**PROKURORIA E PËRGJITHSHME**

# URDHËR

**NR** 60 **DATE** 21 . 11 . 1997

Me qellim për te parandaluar mundësinë e keqinterpretimit te dispozitave procedurale penale, qe bëjnë fjale për rishikimin e çështjeve, si dhe për formimin e një praktike te njëjtë ligjore lidhur me te;

## U R D H Ë R O J :

1. Ne rastet kur nga te dënuarit apo mbrojtësit e tyre kërkohet ne Gjykate rishikimi i çështjes, prokuroret janë te detyruar te vijnë paraprakisht ne Prokurorinë e përgjithshme, me dosjen që kërkohet rishikimi. Me ketë rast do të organizohen konsulta që do te kenë qellim kryesor konsolidimin e praktikes dhe natyrën e një bashkëbisedimi tekniko - profesional.

   Për çdo rast prokurori i çështjes do të paraqes mendimin e tij me shkrim,

2. Ne rastet kur mungojnë dosjet për shkak te djegieve apo shkatërrimeve te muajve te fundit, dhe te dënuarit apo mbrojte-site tyre kërkojnë rishikimin me një kopje te vendimit te dënimit, asnjë prokuror te mos marre pjese ne gjykimin e rishikimit

3. Shkelja e këtij urdhri do të konsiderohet thyerje e rende e disiplinës ne pune.

4. Ky urdhër hyn ne fuqi menjëherë.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

ARBEN RAKIPI

